



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al)

e-mail: [keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al](mailto:keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al)

**V E N D I M**

**Nr. 32, datë 30.5.2017**

**Për dhënien e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme,  
të shkaktuara nga zjarri**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.05.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 8, 9, 40, nenin 54 shkronja "dh", nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika III/1/ shkronja "ë" të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore", udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKB nr.8, datë 30.1.2017 "Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017", me 28 vota pro,

**V E N D O S I :**


1. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Adnan Muka**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 2 (dy) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.
2. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së znj. **Sanije Idrizi**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e saj përbëhet prej 1 (një) anëtarë dhe ndihma financiare të jetë në shumën **20,000** (njëzet mijë) lekë.
3. Burimi i financimit të jetë fondi i drejtorisë së emergjencave civile dhe MZSH-së, parashikuar në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017 të miratuar me VKB nr 8, datë 30.1.2017, në programin P13, F1 O2 A1.




4. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës 60,000 lekë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.


Miratur në datën 30.5.2017  
Shpallur në datën 31.5.2017

**Sekretar i këshillit**

  
\_\_\_\_\_  
**Suel Hadri**

**KRYETAR**

  
\_\_\_\_\_  
**Xhemal BUSHATI**





Pr. 8157 dt. 14.06.2017

Nr.638/1Prot

Shkodër, më 12.06.2017

**Lënda: Lidhur me vendimin nr.32, datë 30.05.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.**

**Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin", ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 29, neni 64, germa c, 40, 54/dh, 55/3 ligjit nr.8756,dt. 26.03.2001 "Per emergjencat civile", i ndryshuar; ligjit nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 "Per menaxhimin e sisitemit buxhetor", i ndryshuar, VKM nr.329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmes ekonomike shtetërore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njezore" kreu III, pika 1, germa "ë", Udhezimit te Perbashket te MPB dhe MF Nr.263 dt.24.05.2013 Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktura nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktura nga veprimtaria njezore", ligjit nr.44/2015 KPAD, neni 56/4, analizo vendimin nr.32, datë 30.05.2017 të Këshillit Bashkiak Shkodër "Per dhënie ndihme financiare familjes së z. Adnan Muka ne shurnen 40.000 leke (sipas aktit të **PMNZSH & procesverbal konstatimi dt 10.04.2017**) për rast fatkeqësie - djegie banese, bashkia Shkodër(qytet), familjes së znj.Sanije Idrizi në shumën prej 20.000 lekë, për fatkeqësi (djegie) bashkia Shkodër- Dobraq i Ri (sipas aktit të **PMNZSH & procesverbal konstatimi dt 10.04.2017**), me burim financimi buxheti i vitit 2017-VKB nr.8/2017".

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni pasi është në të drejtën e të dëmtuarit të përfitojë ndihmën e menjëhershme nga NJQV sipas VKM nr.329 dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmes ekonomike shtetërore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njezore" kreu III, pika 1, germa "ë".

Me respekt,

